

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.84/13 dhe 13/14), pika 3 nënparagrafi 2 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative me ark.nr.0304-1008/1 datë 26.02.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 14-të mbajtur më 08.04.2024, në pajtim me Konkluzionin nr.02-1795/7 datë 09.04.2024 miratoi si vijon:

### **Aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i "The Economist", për shkeljen e kryer të nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për media, në mënyrë që në numri 6 të "The Economist" në dhjetor 2023 nuk ka publikuar të dhënat për adresën e selisë së botuesit të medias (të cilin nuk e publikoi as në numrin 5), dhe përveç kësaj nuk publikoi të dhënat për adresën e redaksisë së botuesit të medias.

1 Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.0304-1008/1 datë 26.02.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi me Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i "The Economist", që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për media.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendim, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

### **A r s y e t i m**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ( Agjencia ), në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i respektimit të harmonizimit të punës së saj me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të ligjit, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi 2 të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas neni 14 paragrafi 1 të LM, botuesi i medias është i detyruar që në vend të dukshëm për çdo bartës të përbajtjes individualisht ( për shembull mostër nga media e shtypit dhe emisioni televiziv) të siguron (ofrojë) publikimin e të dhënave në vijim: emër dhe adresë të selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, domethënë redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin e adresës së shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të botuara, kur kemi të bëjmë me media të shtypit.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, me datë 26.02.2024, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ te subjekti i mbikëqyrjes, botues i medias së shkruara, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ( SHPTSH) KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i "The Economist", nga ku u konstatua se botuesi i medias së shkruar ka vepruar pjesërisht sipas aktvendimit për marrjen e masës – paralajmërim publik ( PA1 nr.03-199, datë 30.05.2023) pra nga të dhënat për mospublikimin e të cilave ishte paralajmëruar më parë, në numrin nr. 6 të "Economist" nga

dhjetori 2023, i ka publikuar vetëm të dhënat për adresën e shtypshkronjës, datën e shtypjes ose ribotimit dhe numrin e kopjeve të shtypura. Përkatësisht, mbikëqyrja ka konstatuar shkelje të nenit 14 paragrafi 1 nga LM, në mënyrë që në numrin nr.6 të "The Economist" nga dhjetori 2023 nuk publikoi të dhënat për adresën e selisë së botuesit të medias (që nuk i publikoi as në numrin 5), dhe përveç kësaj, nuk publikoi të dhënat për adresën e redaksisë së botuesit të medias.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.0304-1008/1 datë 26.02.2024, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHPTSH KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup me 28.02.2024, ka dërguar Shkresë PA1 nr.0304-1008/ 2 datë 28.02.2024, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.0304-1008/1 datë 26.02.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga botuesi i medias së shkruar, me datë 26.03.2024, për të cilën brenda afatit të përcaktuar SHPTSH KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM ark.nr.03-1008/3 datë 02.04.2024. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 08.04.2024, pasi shqyrtoi raportin dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim, konkludoi që ndaj SHPTSH KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi 1 të LM, pika 3 nënparagrafi 2 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) dhe Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.0304-1008/1 datë 26.02.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 14- të mbajtur më 08.04.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1795/7 datë 09.04.2024, ka marrë Vendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHPTSH KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i "The Economist", dhe urdhërohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët 1 dhe 2 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij botuesi i medias ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.0304-1008/1 datë 26.02.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, botuesi i medias së shkruar ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.